



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 6735 /
Prot. 4

Divjakë, më: 15.07.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 44, Datë 15.07 2025

“PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARË TË SHPENZIMEVE PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 PËR BASHKINË DIVJAKË”

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 dt.17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Në përputhje me nenet 4 dhe 24 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

Ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar;

Udhëzimit nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”;

Kuadri Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2026-2028, i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.83 datë 05.02.2025, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028;

Në mbështetje të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.08 datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”;

Vendimit të Këshillit të Bashkisë Divjakë nr.7, datë 24.01.2025 “Për miratimin e raportit të vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave në Bashkinë Divjakë për vitet 2026-2028” dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë Divjakë nr.64 dt.24.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit orientues për menaxhimin e shpenzimeve vendore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”.

Kërkojmë që Këshilli i Bashkisë Divjakë në mbledhjen e datës 25/07/2025,-

Të Miratojë:

I-Tavanet përfundimtarë të shpenzimeve për Programin Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028 për Bashkinë Divjakë, sipas pasqyrës bashkëlidhur:

a)Tavanet përfundimtarë të shpenzimeve për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Divjakë:

	Parashikim	Parashikim	Parashikim
“Tavanet Përfundimtarë” (në lekë)	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Totali (Pa përfshirë Transfertën e Kushtëzuar)	789,320,726	793,506,597	805,006,960

b)Tavanet përfundimtarë të shpenzimeve për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Divjakë duke përfshirë financimin e huaj (02) Projekti JOINABLE.



“Tavanet Përfundimtarë duke përfshirë (02) Projektin JOINABLE” (në lekë)

	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Totali (Pa përfshirë Transfertën e Kushtëzuar)	793,172,304	797,044,959	805,006,960

Përgjegjës i Sektorit Juridik, Prokurimeve Publike dhe Menaxhimit Aseteve
Andi BULLARI

Drejtoresë së Taksave dhe Të Ardhurave Vendore
Alketa HILA

Specialiste e MFK
Marinela PERRIU

Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit
Xheladin BRAHKOLA

KRYETARI

Josif GORREA

